SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurisë së paluajtshme pronë private, e cila preket si rezultat i rrëshqitjes në aksin rrugor Elbasan-Librazhd.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pasurinë sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronari i pasurisë që figuron në listën emërore, si dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Lidhur me shënimin “proces verifikimi” në kolonën respektive, sqarojmë se pritet konfirmimi nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Librazhd. Deri në momentin e konfirmimit për titullin e pronësisë nga kjo zyrë, paratë do të qëndrojnë të bllokuara në bankë.

LISTA E PASURISË SË PREKUR SI REZULTAT I RRËSHQIJTES NË AKSIN RRUGOR ELBASAN-LIBRAZHD

Pronari	Zona kadastrale	Nr.pasurisë	Sip arë m^2	Çmimi lekë/m^2	Vlera lekë	Vlera totale e shpronësimit	Shënime
I paidentifikuar	1063	603/2	385	350	134 750	134 750	Proces verifikimi

Vlera totale e këtij shpronësimi është 134 750 (njëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë.